



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.957/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatja për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt Sala Jashari nga Subjekti Politik Lista e Pavarur , me seli në Skenderaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.957/2021 i datës 04.11.2021, kandidatja për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt Sala Jashari nga Subjekti Politik Lista e Pavarur , me seli në Skenderaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, më të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 2101X/03R.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.945/2021, e paraqitur kandidatja për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt Sala Jashari nga Subjekti Politik Lista e Pavarur , me seli në Skenderaj, me të cilën pretendon se në vendvotimin 2101X/03R sipas FRP ka 66 vota ndërsa pas rinumërimit dhe ne rezultatet përfundimtare te publikuara nga KQZ ne këtë qendër ka vetëm 6. Në apel ka bashkangjitur FRP për votat e numëruara për kandidatet për asamble ne këtë qendër votimi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Apeli është i pa bazuar**

Kandidatja për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt Sala Jashari nga Subjekti Politik Lista e Pavarur , me seli në Skenderaj ,brenda afatit ligjor ka parashtruar apel me të cilën pretendon se në vendvotimin 2101X/03R sipas FRP ka 66 vota ndërsa pas rinumërimit dhe ne rezultatet përfundimtare te publikuara nga KQZ ne këtë qendër ka vetëm 6.

Apeluesi nuk e bindi paneli për domosdoshmërinë e rinumërimit te serishëm te vendvotimit ne fjale, meqenëse veç ka shkuar ne rinumërim një here vendvotimi ne fjale, dhe pas rinumërimit ka rezultuar gjendja qe është evidente, mirëpo apeluesi nuk ka dorëzuar ndonjë prove bindëse por vetëm i është referuar ndryshimit te votave pas rinumërimit, e qe nuk përbën as prove për dyshim se ka pasur ndërhyrje apo manipulim.

Nuk mund te ketë rinumërim pasi qe ne këtë vendvotim ka pasur rinumërim dhe ne rinumërim është konstatuar saktë numri i votave te kandidatës.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.957/2021 më datën 07.11.2021**

**Kryesuesi i Panelit**  
**Milena Đeric**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.***